

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	00.Nr.115 /2025	Data: 30.04.2025	

Kuvendi i Komunës, në bazë të nenit 14, paragrafi 1, neni 58 pika h) të Ligjit Nr. 03/L - 040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/04 Qershor 2008), neni 14 paragrafi 1, nen paragrafi 1.1, neni 15 paragrafi 2, neni 16 paragrafi 1, të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike, si dhe bazuar në dokumentet e planifikimit hapësinor të Komunës së Istogut HZK (2024-2032), kërkesës e cila mban shenjen Nr.01-016-16276, të datës 22.05.2025 si dhe rekomandimit nga Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF) e mbajtur me datën 29.05.2025 në mbledhjen e mbajtur më 30.05.2025 mori këtë:

VENDIM

PËR BARTJEN E PRONËS PUBLIKE KOMUNALE KOMPANISË PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVË (KMDK) SH.A (Zona Kadastrale në Tuqep)

1. Miratohet - propozim vendimi i Kryetarit të Komunës për bartjen e pronës publike komunale (kalimin e pronësisë) Kompanisë për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK) SH.A saktësisht sipërfaqen prej (9500) m² nga pjesa e përgjithshme e sipërfaqes të parcelës prej (20757)m² nga njësia kadastrale me nr.P-70806003-00463-2, dhe pjesën e sipërfaqes të parcelës prej (18500)m², nga pjesa e përgjithshme e sipërfaqes prej (104576)m² nga parcela e evidentuar sipas njësisë kadastrale me nr.P-70806003-00501-2, Zona Kadastrale në Bellopojë evidentuar sipas certifikatës pronësore pronë e komunës së Istogut.
2. Bazuar në pikën 1 të këtij propozim vendimi ky projekt (ndërmjet dy institucioneve) është i një rëndësie të veçantë ku si projekt synon që të adresojë, çështjen e mbylljes së deponisë sipas standardeve evropiane në fuqi si dhe mirëmbajtjen/menaxhimin pas mbylljes së deponisë (rehabilitimit) duke konsideruar si projekt me interes të veçantë publik.
3. Bartja e parcelës (kalimi i pronësisë) sipas pikës 1 të këtij vendimi ka për qëllim investimin në rivitalizimin (mbylljen sipas standardeve) sipas marrëveshjes së financimit, nga Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës (KMDK) ku investimi planifikohet në vlerë prej 1.8 milion realizimi i të cilit pritet të përfundojë në afat dy vjeçar, sipas mandatit ligjor të KMDK-së.
4. Ky Vendim hynë në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit të tij në faqen zyrtare të Komunës. Për realizimin e këtij Vendimi do të kujdesen : Kryetari i Komunës, Drejtoria për Kadastër Pronë, dhe Gjeodezi si dhe Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis.
5. Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Kuvendi i Komunës, Drejtoria për Kadastër Pronë, dhe Gjeodezi, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis, Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

00/ Nr./Br. 033- 28 Nr. i faq/Bešte 01

Data/Date 04.06.2025

ISTOG - ISTOK

Kryesuesi i Kuvendit
z. Enver Rugova

Enver Rugova